



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 230/8 prot

Datë 22.02.2024

V E N D I M

Nr. 215/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.02.2024 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Health&Light” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-85014-10-24-2023, me objekt: “*Loti 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent*”, me fond limit 88 858 534.38 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me adresë: Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë.

Ankimues: “Health & Light” SHPK, me NUIS L42231011L, me adresë: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd.11, Shk.4, Ap.4, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit

Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.10.2023, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-85014-10-24-2023, me objekt: “Loti I - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent” me fond limit 88 858 534.38 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 25.01.2023, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave si më poshtë vijon:

“MSE” SHPK	68.400.000 lekë, skualifikuar
“Helth&Light” SHPK	88.815.450 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Helth&Light” SHPK, është njoftuar për arsyet e skualifikimit të tij si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

- Sigurimi i ofertës për Lot 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent 1 777 170,688 (një milion shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëmbëdhjetë, presje 688) Lekë.

Diferenca ndërmjet ofertës së rënditur në vend të pare, dhe ofertës së renditur në vend të dytë, është 20 415 450 (njëzet milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë.

Për këtë arsye, bazuar në Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285/2021, nuk është i mundur kalimi nga oferta e parë tek oferta vijuese. (Neni 30/8).

Gjithsesi, në vijim të rivlerësimit të bërë, pasqyruar si më sipër, KVO konstatoi se pranë AK QSUNT, është administruar raporti përfundimtar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me nr. 175/151 prot., datë 28.12.2023, ku në faqen 225 – 226, si dhe faqen 312, pika 12, ndër të tjera citon se: Për procedurën e prokurimit me objekt: Mirembajtja full risk e pajisjeve mjekësore, për nevojat e QSUNT për 24 muaj, e ndarë në 62 lote, MK...; në ofertën e dorëzuar nga OE Health & Light Shpk., citohet se: ...Pjesët e dëmtuara pas zëvendësimit me të reja, do të merren nga Health & Light Shpk., shënim i cili është në kundërshtim dokumentet e tenderit/Njoftimin e shkurtuar të kontratës...;

Për këtë arsye, si dhe duke u bazuar në dokumentacionin e ofertës të këtij OE për Lot 1 si më sipër, në shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, operatori ekonomik ka paraqitur, ndër të tjera, shënimet vijuese:

“1-Pjesët e dëmtuara , të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga Health & Light sh.p.k.

2-Përsa i përket kërkesës në pikën 7 të specifikimeve teknike, mirëmbajtja korrigjuese: Shoqëria e kontraktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën pajisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor,

Ju bëjmë me dije se po ruajmë këtë çmim duke ditur që pajisjet janë transferuar së fundmi dhe nuk do të spostohen më.

Përsa i përket rezonancës magnetike, është e pamundur që të transferohen dhe kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës. Përgjegjësinë për to e mbani ju. Kjo është një procedurë për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe nuk kanë lidhje me zhvendosjen dhe nuk është klauzolë e trashëguar nga një kontratë e mëparshme për këto pajisje.”

Lidhur me parashikimin se “1-Pjesët e dëmtuara , të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga Health & Light sh.p.k.”, KVO në zbatim të rekomandimit të KLSH për këtë parashikim, si dhe referuar kontratës së shpallur në këto DT, lloji i mirëmbajtjes është ‘full risk’ që do të thotë që OE i shpallur fitues, duhet të mbulojë të gjitha defektet e pajisjes, e cila është në regjim mirëmbajtje, sipas termave të references, ku përfshihen edhe pjesët e këmbimit.

Bazuar në Ligjin nr. 162, date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 92 ‘Shqyrtimi i ofertave’, pika 3 ku parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të

këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji, si dhe parashikimet e VKM 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, neni 82, pika 2, ku citohet se: 2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuar në dokumentet e tenderit; ii. “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuar në dokumentet e tenderit; dhe iii. “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, oferta e paraqitur nga OE Health & Light Shpk., për këtë procedurë prokurimi, është në kushtet e ‘mospranimit’ dhe ‘rezervimit’ të termave të referencës së parashikuar në DT, duke marrë mbrapsh pjesët e këmbimit që zëvendësohen nga pajisjet mjeksore, për këtë arsye kjo ofertë është e pavlefshme..”

II.3. Në datën 26.01.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 31.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 230/2024 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3782, e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-85014-10-24-2023, me objekt: “Loti 1 - Mirëmbajtje Pajisje mjeksore prodhues Philips /ose ekuivalent” me fond limit 88 858 534.38 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Health&Light” SHPK.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Autoriteti kontraktor rendit si arsye për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana jonë ato si më poshtë:

I. Sigurimi i ofertës për Lot 1 - Mirembajtje Pajisje mjeksore prodhues Philips /ose ekuivalent 1 777 170,688 (një milion shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëmbëdhjetë, presje 688) Lekë.

Diferenca ndërmjet ofertës së renditur në vend të parë, dhe ofertës së renditur në vend të dytë, është 20 415 450 (njëzet milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë.

Për këtë arsye, bazuar në Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285/2021, nuk është i mundur kalimi nga oferta e parë tek oferta vijuese. (Neni 30/8).

2. Duke u bazuar në dokumentacionin e ofertës të këtij OE për Lot 1 si më sipër, në shtojcën I “Formulari i ofertës”, operatori ekonomik ka paraqitur, ndër të tjera, shënimet vijuese:

“1-Pjesët e dëmtuara , të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga Health & Light sh.p.k.

2-Për sa i përket kërkesës në pikën 7 të specifikimeve teknike, mirëmbajtja korrigjuese: Shoqëria e kontraktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën pajisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor,

Ju bëjmë me dije se po ruajmë këtë çmim duke ditur që pajisjet janë transferuar së fundmi dhe nuk do të spostohen më.

Për sa i përket rezonancës magnetike, është e pamundur që të transferohen dhe kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës. Përgjegjësinë për to e mbani ju. Kjo është një procedurë për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe nuk kanë lidhje me zhvendosjen dhe nuk është klauzolë e trashëguar nga një kontratë e mëparshme për këto pajisje.”

- Në lidhje me pikën 1 të arsyetimit të KVO-së, ju bëjmë me dije se ajo është e pabazë, pasi referuar neni 83 “Sigurimi i ofertës”, pika 6 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:

“6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës.

Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.”

Pra me fjalë të tjera, kjo pikë do të qëndronte nëse operatori ekonomik i cili ka paraqitur ofertën më të ulët, do të ishte shpallur fitues dhe nuk do të kishte bërë sigurimin e kontratës ose nuk do të nënshkruante kontratën. Në rastin tonë operatori ekonomik i cili ka paraqitur ofertën më të ulët është skualifikuar.

- Në lidhje me pikën 2 të arsyetimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, përsëri ata kanë vëpruar në kundërshtim me nenin 80 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Referuar këtij neni, oferta e paraqitur nga ana jonë do të vlerësohet vetëm në bazë të kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tendetit (DT). Asnjë kërkesë tjetër nuk duhet të bëhet shkak për skualifikimin e ofertës. Në asnjë pikë të specifikimeve teknike të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, nuk është kërkuar që pjesët e këmbimit të dëmtuara, pas zëvendësimit me të reja, të mbeten në pronësi të autoritetit kontraktor. Pra një kërkesë e tillë është antiligjore dhe abuzive.

Gjithashtu ju bëjmë me dije, se gjatë fazës së studimit të tregut që realizoi Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” për këtë procedurë prokurimi, ne kemi paraqitur 2 oferta.

- Varianti i I-rë, oferta më e ulët, me kusht që pjesët e dëmtuara të këmbimit, pas zëvendësimit me të reja, merren nga “Health&Light SHPK për t’iu kthyer kompanisë prodhuese.

- *Varianti i II-të, ofera më e lartë, me kushtin që pjesët e dëmtuara të këmbimit, pas zëvendësimit metë reja, mbeten në pronësi të institucionit tuaj.*

Fondi limit i kësaj procedure prokurimi, është shpallur bazuar në Variantin e I-rë, ofertën më të ulët.

- *Në pikën 2 (b) të arsytimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, përsëri ky arsyetim nuk qëndron, pasi në asnjë pikë ne nuk kemi deklaruar që nuk i transferojmë, por përkundrazi kemi shprehur qartë që e kryejmë këtë proces dhe do të mbajmë të njëjtën vlerë oferte, ashtu sic kemi kryer edhe eshërbime mirëmbajtje falas, pa patur një kontratë me institucionin tuaj.*

Gjithsesi ju keni patur të gjithë hapësirën ligjore që të kërkonit sqarim, referuar nenit 92, pika 1 të LPP-së ku citohet: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.”

Gjithashtu në Buletinin e Prokurimit Publik nr.4, datë 29 Janar 2024, është publikuar anulimi i kësaj procedure prokurimi. Në pikën 7 të këtij njoftimi shprehet: Informacion shtesë: (shënim: Në këtë procedurë prokurimi, është bërë gabim emërtimi i objektit në SPE).

Pas konsultimit me avokatët tanë, ata na deklaruan që nuk ka asnjë gabim dhe mund të jetë një lapsus.

Kërkojmë anulimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana jonë dhe një vlerësim të drejtë të ofertës, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik dhe VKM respektive.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 230/2, datë 01.02.2024, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ““Health&Light” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 230 prot., datë 31.01.2024.

II.6. Në datën 13.02.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 230/3 prot., formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatori ekonomik “MSE” SHPK, me anë të të cilit kërkohet të mbetet i skualifikuar operatori ekonomik “Health & Light” SHPK dhe vijimin me hapat e mëtejshëm të kësaj procedure prokurimi, sipas përcaktimeve ligjore të parashikuara në LPP.

II.7. Me shkresën me nr. 230/4 prot., datë 15.02.2024, me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Health&Light” SHPK”, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës së paraqitur nga shoqëria “Health & Light” SHPK, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dërgojë pranë këtij Komisioni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të

prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik "Health&Light" SHPK si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së lartpërmendur.

II.8. Në datën 21.02.2024, është protokolluar në KPP me nr. 230/5 prot., shkresa e autoritetit kontraktor 394/4 prot., datë 16.02.2024.2024, me objekt: "Kthim - përgjigje mbi Formularin e Ankesës të administruar me nr. 394 prot., datë 31.01.2024 nga OE "Health & Light" Shpk", drejtuar shoqërisë "Health & Light" Shpk, për dijeni KPP-së dhe operatorit ekonomik "MSE" SHPK. Me anë të kësaj shkrese, informohet Komisioni i Prokurimit Publik mbi refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik "Health & Light" SHPK. Shprehimisht autoriteti kontraktor ka arsyetuar si më poshtë vijon:

"Në bazë dhe për zbatim të Urdhrit të Brendshëm nr. 36 datë 02.02.2024 për krijimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës në lidhje me ankesën e paraqitur nga OE "Health&Light" Sh.p.k. me Nr. 394 Prot., datë 31.01.2024, për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – Shërbime – Prokurim me Mjete Elektronike, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (me një OE fitues për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në zbatim të parashikimeve ligjore të nenit 110 dhe 112 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", bëri verifikimet paraprake mbi ankesën dhe vendosi ta marri në shqyrtim pasi:

1. Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor 10 ditor të përcaktuar për paraqitjen e ankesave për vlerësimin e procedurave.
2. Ankesa konfirmohet të jetë paraqitur dhe publikuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 31.01.2024.

Rrethanat e çështjes dhe Pretendimet e operatorit ekonomik:

Në datën 25.01.2024, në Sistemin elektronik të prokurimit Publik na ka ardhue mesazh mbi refuzimin e ofertës së paraqitur nga ana jonë për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 1 – Mirëmbajtje pajisje mjekësore prodhues Philips / ose ekuivalent, REF-85014-10-24-2023 dhe fond limit: 8 858 534.38 (tetëdhjetë e tetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër pikë tridhjetë e tetë) Lekë pa TVSH. Duke analizuar me kujdes arsyet e skualifikimit, vërejmë që shkaqet e skualifikimit janë në kundërshtim me ligjin Nr. 162/2020 Për prokurimin publik, Neni 80, 83 pika 6. dhe 92 pika 1. Më poshtë po japim argumentimet në lidhje me shkeljet e pretenduara.

Argumentim nga OE mbi shkeljet e pretenduara.

1. Sigurimi i ofertës për Lot 1 – Mirëmbajtje Pajisje mjekësore Philips / ose ekuivalent 14 777 170,688 (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëmbëdhjetë presje 688) Lekë. Diferenca ndërmjet ofertës së rënditur në vend të parë, dhe ofertës së rënditur në vend të dytë, është 20 415 450 (njëzet milion e katërqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë. Për këtë arsye, bazuar në Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285/2021, nuk është i mundur kalimi nga oferta e parë tek oferta vijuese. (Neni 30/8)

2. Duke u bazuar në dokumentacionin e ofertës të këtij OE për Lot 1 si më sipër, në shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, operatori ekonomik ka paraqitur, ndër të tjera, shënimet vijuese:

- a) 1-Pjesët e dëmtuara, të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga Health & Light sh.p.k
 - b) 2-Përsa i përket kërkesës në pikën 7 të specifikimeve teknike, mirëmbajtja korigjuese: Shoqëria e kontaktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën paisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti kontraktor, ju bëjmë me dije se po ruajmë këtë çmim duke ditur që pajisjet janë transferuar së fundmi dhe nuk do të spostohen më. Për sa i përket rezonancës magnetike, është e pamundur që të transferohen dhe kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës. Përgjegjësinë për to e mbani ju. Kjo është një procedurë për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe nuk kanë lidhje me zhvendosjen dhe nuk është klauzolë e trashëguar nga një kontratë e mëparshme për këtë pajisje.
- Në lidhje me pikën 1 të arsytimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ju bëjmë me dije se ajo është e pabazë, pasi referuar Nenit 83 Sigurimi i Ofertës, pika 6 të Ligjit Nr. 162/2020 për Prokurimin Publik, ku citohet:

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës.

Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e rënditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës së ofertuesit që është tërhequr

Pra, me fjalë të tjera, kjo pikë do të qëndronte nëse operatori Ekonomik i cili ka paraqitur ofertën më të ulët do të ishte shpallur fitues dhe nuk do të kishte bërë sigurimin e kontratës ose nuk do të nënshkruante kontratën. Në rastin tonë, Operatori Ekonomik i cili ka paraqitur ofertën më të ulët është s’kualifikuar.

Në lidhje me pikën 2 (a) të arsytimit të komisionit të Vlerësimit të Ofertave, përsëri ata kanë vepruar në kundërshtim me nenin 80 të ligjit Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik.

Referuar këtij neni, oferta e paraqitur nga ana jonë do të vlerësohet vetëm në bazë të kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit (DT). Asnjë kërkesë tjetër nuk duhet të bëhet shkak për skualifikimin e ofertës. Në asnjë pikë të specifikimeve teknike të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT nuk është kërkuar që pjesët e këmbimit të dëmtuara, pas zëvendësimit me të reja të mbetën në pronësi të autoritetit kontraktor, pra, një kërkesë e tillë është antiligjore dhe abuzive.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se gjatë fazës së studimit të tregut që realizoi Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” për këtë procedurë prokurimi, ne kemi paraqitur dy oferta:

-Varinti i I-rë, oferta më e ulët, me kushtin që pjesët e dëmtuara të këmbimit pas zëvendësimit me të reja merren nga Health & Light sh.p.k për t'iu kthyer kompanisë prodhuese:

Varianti i II-të, oferta më e lartë, me kushtin që pjesët e dëmtuara të këmbimit pas zëvendësimit me të reja mbeten në pronësi të Institucionit Tuaj.

Fondi limit i kësaj procedure prokurimi është shpallur bazuar në variantin e I-rë, ofertën më të ulët.

- *Në lidhje me pikën 2 (b) të arsytimit të komisionit të Vlerësimit të Ofertave, përsëri ky arsyetim nuk qëndron, pasi asnjë pikë ne nuk deklarojmë që nuk i transferojmë, por përkundrazi kemi shprehur qartë që e kryejmë këtë proces dhe do të mbajmë të njëjtën vlerë oferte, ashtu siç kemi kryer edhe shërbime mirëmbajtje falas, pa patur një kontratë me Institucionin tuaj.*

Gjithsesi, ju keni patur hapësirën ligjore që të kërkonit sqarim, referuar Nenit 92 pika 1, të Ligjit Nr, 162/2020 Për Prokurimin Publik ku citohet:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të ketyre ofertave. Pa canuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Gjithashtu, në Buletinin e Prokurimit Publik Nr. 4 datë 29 janar 2024, është publikuar anullimi i kësaj procedure prokurimi. Në pikën 1 të këtij njoftimi shprehet: Informacione shtesë: (shënim: Në këtë procedurë prokurimi, është bërë gabim emërtimi në i objektit në SPE).

Pas konsultimit me avokatët tanë, ata na deklaruan që nuk ka asnjë gabim dhe mund të jetë një lapsus.

Kërkojmë anulimin të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për s'kualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana jonë dhe një vlerësim të drejtë të ofertës, bazuar në ligjin e Prokurimit Publik dhe VKM respektive.

Shqyrtimi i KSHA

Në zbatim të dispozitave ligjore të parashikuara në pikën 2 dhe 8 të nenit 110 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", nenit 97 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, DST-së, si dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, KSHA konstaton se:

Ankuesi OE "Health & Light" Sh.p.k., në lidhje me procedurën objekt ankimi, ka ushtruar të drejtën ligjore të ankimit brenda afatit të parashikuar në nenit 110, të LPP, për sa i përket vendimit të vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO) për lotin 1.

Për sa i përket pretendimeve të OE ankimes, KSHA mori në shqyrtim pretendimet e ngritura, duke konstatuar si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik Health & Light sh.p.k., me NIPT L422J1011L, përmes ankesës së depozituar pranë KPP në Sistemin Elektronik të Ankesave dhe pranë AK QSUNT, administruar

me Nr. 394 Prot., datë 31.01.2024, ka paraqitur kundërshtimet përkatëse (sikurse është parashtruar më lart).

I. Për sa i përket argumentit të OE ankues lidhur me pretendimin e parë, KSHA vëren se:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës mori në shqyrtim pretendimin, në të cilin OE ankues argumenton se: 1. Sigurimi i ofertës për Lot 1 – Mirëmbajtje Paijsje mjekësore Philips / ose ekuivalent 14 777 170,688 (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëmbëdhjetë presje 688) Lekë. Diferenca ndërmjet ofertës së rënditur në vend të parë, dhe ofertës së rënditur në vend të dytë, është 20 415 450 (njëzet milion e katërqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë. Për këtë arsye, bazuar në Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285/2021, nuk është i mundur kalimi nga oferta e parë tek oferta vijuese.

(Neni 30/8), ...[....]... 6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës.

Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e rënditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës së ofertuesit që është tërhequr

Pra, me fjalë të tjera, kjo pikë do të qëndronte nëse operatori Ekonomik i cili ka paraqitur ofertën më të ulët do të ishte shpallur fitues dhe nuk do të kishte bërë sigurimin e kontratës ose nuk do të nënshkruante kontratën. Në rastin tonë, Operatori Ekonomik i cili ka paraqitur ofertën më të ulët është s’kualifikuar...[...];

Për sa i përket këtij pretendimi të OE, KSHA verifikoi të gjithë dokumentacionin e administruar nga KVO, ku së pari rezulton se: OE MSE shpk., ka qenë operator ekonomik i kualifikuar, i renditur i pari, arsye e skualifikimit të këtij OE, referuar PV se mbajtur nga KVO, rezulton të jetë mosplotësimi i dokumentacioni të vetëdeklaruar...; Në PV e administruar ndër të tjera citohet se: **Brenda afatit të cituar më sipër, nga OE MSE shpk., për këtë lot nuk u paraqit dokumentacioni i citur në PV për këtë arsye, oferta e paraqitur nga ky OE nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit dhe specifikimeve teknike të publikuar në sistemin e prokurimit elektronik në faqen e APP-se, në mbështetje të VKM 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, neni 80, pika 4, dhe Ligjin nr. 162, date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.**

Referuar VKM 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, neni 30, pika 8, ku parashikohet se: 8. Në rastin kur, është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe asaj në vend të dytë, është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr. Me

të njëjtin rregull, mund të kalohet tek ofertat e renditura në vijim në rast se diferenca e ofertës së radhës me ofertën fituese fillestare, të mos jetë më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, të renditur para saj.

Për sa më sipër:

- *Fondi Limit për Lotin 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent, me Fond Limit për 24 muaj: 88 858 534.38 (tetëdhjetë e tetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër pikë tridhjetë e tetë) Lekë pa TVSH dhe 106 630 241.26 (njëqind e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e dyqind e dyzet e nje pikë njezet e gjashtë Lekë me TVSH;*
- *Sigurimi i ofertës për Lot 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent 1 777 170,688 (një milion shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëmbëdhjetë, presje 688) Lekë.*
- *Oferta e paraqatur nga Operatori ekonomik “MSE” sh.p.k, me nr. Nipt-i L82001005A, me adrese: Rruga Diga e Liqenit, nr. pasurie 8/312, vol. 25, fq. 40, zona kadastrale 8270, Tirane, me vlere ofertës ekonomike prej 68,400,000 (gjashtëdhjetë e tete milion e katerqind mijë) Leke pa TVSH dhe 82,080,000 (tetëdhjetë e dy milion e tetëdhjetë mijë) Leke me TVSH.*
- *Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Health & Light” sh.p.k., me nr. Nipt-i L42231011L, me adrese Rruga Themistokli Germenji, Nd. 11, H. 4, Ap. 4, Njesia Administrative Nr. 2, 1010, Tirane, me vlere ofertës ekonomike prej 88,815,450 (tetëdhjetë e tete milion e teteqind e pesëmbëdhjetë mijë e katerqind e pesëdhjetë) Leke pa TVSH dhe 106,578,540 (njëqind e gjashtë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tete mijë e pesëqind e dyzete) Leke me TVSH.*

Diferenca ndërmjet ofertës së rënditur në vend të pare, dhe ofertës së renditur në vend të dytë, është 20 415 450 (njëzet milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë.

Për këtë arsye, referuar parashikimeve të Nenit 30/8 të RrPP, si dhe Nenit 98 ‘Anulimi i një procedure prokurimi’, pika 1, germa b, ku parashikohet se: 1. Autoriteti ose entë kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;

Gjithsesi, në vijim të rivlerësimit të bërë, pasqyruar si më sipër, KVO konstatoi se pranë AK QSUNT, është administruar raporti përfundimtar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me nr. 175/151 prot., datë 28.12.2023, ku në faqen 225 – 226, si dhe faqen 312, pika 12, ndër të tjera citon se: Për procedurën e prokurimit me objekt: Mirembajtja full risk e pajisjeve mjekësore, për nevojat e QSUNT për 24 muaj, e ndarë në 62 lote, MK...; në ofertën e dorëzuar nga OE Health & Light Shpk., citohet se: ...Pjesët e dëmtuara pas zëvendësimit me të reja, do të merren nga Health & Light Shpk., shënim i cili është në kundërshtim dokumentet e tenderit/Njoftimin e shkurtuar të kontratës...;

Për këtë arsye, si dhe duke u bazuar në dokumentacionin e ofertës të këtij OE për Lot 1 si më sipër, në shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, operatori ekonomik ka paraqitur, ndër të tjera, shënimet vijuese:

“1-Pjesët e dëmtuara , të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga Health & Light sh.p.k.

2-Përsa i përket kërkesës në pikën 7 të specifikimeve teknike, mirëmbajtja korrigjuese: Shoqëria e kontraktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën pajisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, Ju bëjmë me dije se po ruajmë këtë çmim duke ditur që pajisjet janë transferuar së fundmi dhe nuk do të spostohen më. Përsa i përket rezonancës magnetike, është e pamundur që të transferohen dhe kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës. Përgjegjësinë për to e mbani ju. Kjo është një procedurë për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe nuk kanë lidhje me zhvendosjen dhe nuk është klauzolë e trashëguar nga një kontratë e mëparshme për këto pajisje.”

Lidhur me parashikimin se “1-Pjesët e dëmtuara , të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga Health & Light sh.p.k.”, KVO në zbatim të rekomandimit të KLSH për këtë parashikim, si dhe referuar kontratës së shpallur në këto DT, lloji i mirëmbajtjes është ‘full risk’ që do të thotë që OE I shpallur fitues, duhet të mbulojë të gjitha defektet e pajisjes e cila është në regjim mirëmbajtje sipas termave të references, ku përfshihen edhe pjesët e këmbimit.

*Bazuar në Ligjin nr. 162, date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 92 ‘Shqyrtimi i ofertave’, pika 3 ku parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme **vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji, si dhe parashikimet e VKM 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, **neni 82, pika 2, ku citohet se: 2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, oferta e paraqitur nga OE Health & Light Shpk., për këtë procedure prokurimi, është në kushtet e ‘mospranimit’ dhe ‘rezervimit’ të termave të references së parashikuar në DT duke marrë mbrapsh pjesët e këmbimit që zëvendësohen nga pajisjet mjeksore, për këtë arsye kjo ofertë e pavlefshme.***

Për sa i përket qëndrimin të KVO, KSHA konstaton se në VKM 285/2021, Neni 30/8, citohet: 8. Në rastin kur, është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht

më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe asaj në vend të dytë, është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr. Me të njëjtin rregull, mund të kalohet tek ofertat e renditura në vijim në rast se diferenca e ofertës së radhës me ofertën fituese fillestare, të mos jetë më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, të renditur para saj.

Pra në këtë parashikim të VKM, në lex scripta, përcaktohet dy kushte kur AK, mund të kalojë tek oferta e renditur e dyta, konkretisht: 1. Kur ofertuesi nuk bën sigurimin e kontratës, ose, 2, kur ofertuesi nuk arrin të nënshkruajë kontratën. Në referim të sa përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, pavarësisht parimit, Dura lex, sed lex, KVO ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore, pasi:

- *Fondi Limit për Lotin 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent, me Fond Limit për 24 muaj: 88 858 534.38 (tetëdhjetë e tetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër pikë tridhjetë e tetë) Lekë pa TVSH dhe 106 630 241.26 (njëqind e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e dyqind e dyzet e nje pikë njezet e gjashtë Lekë me TVSH;*
- *Sigurimi i ofertës për Lot 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent 1 777 170,688 (një milion shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëmbëdhjetë, presje 688) Lekë.*
- *Oferta e paraqatur nga Operatori ekonomik “MSE” sh.p.k, me nr. Nipt-i L82001005A, me adrese: Rruga Diga e Liqenit, nr. pasurie 8/312, vol. 25, fq. 40, zona kadastrale 8270, Tirane, me vlere ofertës ekonomike prej 68,400,000 (gjashtëdhjetë e tete milion e katerqind mijë) Leke pa TVSH dhe 82,080,000 (tetëdhjetë e dy milion e tetëdhjetë mijë) Leke me TVSH.*
- *Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Health & Light” sh.p.k., me nr. Nipt-i L42231011L, me adrese Rruga Themistokli Germenji, Nd. 11, H. 4, Ap. 4, Njesia Administrative Nr. 2, 1010, Tirane, me vlere ofertës ekonomike prej 88,815,450 (tetëdhjetë e tete milion e teteqind e pesëmbëdhjetë mijë e katerqind e pesëdhjetë) Leke pa TVSH dhe 106,578,540 (njëqind e gjashtë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tete mijë e pesëqind e dyzete) Leke me TVSH.*

Diferenca ndërmjet ofertës së rënditur në vend të parë, dhe ofertës së renditur në vend të dytë, është 20 415 450 (njëzet milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë.

Për këtë arsye, për sa pretendohet nga OE Ankues, KSHA konstaton se ky pretendim nuk qëndron.

II. Për sa i përket argumentit të OE ankues lidhur me pretendimin e dytë, KSHA vëren se:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës mori në shqyrtim pretendimin, në të cilin OE ankues argumenton se “(...) Gjithsesi, Ju keni patur të gjithë hapësirën ligjore që të kërkonit sqarim,

referuar Nenit 92 pika 1, të ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, ku citohet: 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.” (Pretendimi i plotë gjendet në pjesën hyrëse të këtij vendimi)

KSHA u njoh me dokumentacionin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” sh.p.k., në brendësi të të cilit u evidentuan edhe shënimet në Shtojcën nr.2 “Lista e çmimeve të shërbimeve”, se “**Pjesët e dëmtuara, të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga Health&Light shpk. Përsa i përket kërkesës në pikën 7 të specifikimeve teknike, mirëmbajtja korigjuese: Shoqëria e kontraktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën pajisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohej nga Autoriteti Kontraktor, Ju bëjmë me dije se po ruajmë këtë çmim duke ditur që pajisjet janë transferuar së fundmi dhe nuk do të spostohen më. Përsa i përket rezonancës magnetike, është e pamundur që të transferohen dhe kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës. Përgjegjësinë për to e mbani ju. Kjo është një procedurë për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe nuk kanë lidhje me zhvendosjen dhe nuk është klauzolë e trashëguar nga një kontratë e mëparshme për këto pajisje.**”

Sjellim në vëmendje se, në nenin 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, fjalia e parë e pikës 1 nxjerr në pah diskrecionin e autoritetit kontraktor sa i takon kërkimin të sqarimeve nga ofertuesit. Ky diskrecion i dhënë nga ligjvënësi sipas kësaj pike ushtrohet konform frymës së legjislacionit të prokurimit publik në RSH, duke respektuar qëllimet dhe parimet e përgjithshme të prokurimit publik, me qëllim shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Theksojmë këtu se autonomia / diskrecioni i dhënë nga kjo dispozitë duhet të ushtrohet sa më objektivisht dhe duke ballafaquar saktë dhe pa ekuivoke bazën ligjore me dokumentacionin e ofertës.

Nga detajet e vlerësimit, vihet re se oferta e operatorit ekonomik “Health & Light” sh.p.k. është gjetur e cenueshme dhe është skualifikuar, **ndër të tjera**, për shënimin e sipërcituar, me arsyetimin se “Lidhur me parashikimin se “1-Pjesët e dëmtuara , të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga Health & Light sh.p.k.”, KVO në zbatim të rekomandimit të KLSH për këtë parashikim, si dhe referuar kontratës së shpallur në këto DT, lloji i mirëmbajtjes është ‘full risk’ që do të thotë që OE I shpallur fitues, duhet të mbulojë të gjitha defektet e pajisjes e cila është në regjim mirëmbajtje sipas termave të references, ku përfshihen edhe pjesët e këmbimit.

Bazuar në Ligjin nr. 162, date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 92 ‘Shqyrtimi i ofertave’, pika 3 ku parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji, si dhe parashikimet e VKM 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, neni 82, pika 2, ku citohet se: 2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e

dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, oferta e paraqitur nga OE Health & Light Shpk., për këtë procedure prokurimi, është në kushtet e ‘mospranimit’ dhe ‘rezervimit’ të termave të references së parashikuar në DT duke marrë mbrapsh pjesët e këmbimit që zëvendësohen nga pajisjet mjeksore, për këtë arsye kjo ofertë e pavlefshme.”

Në rastin konkret, sikurse vërehet nga dokumentacioni i ofertës dhe vlerësimi i KVO, shënimet e bëra në listën e çmimeve të shërbimeve e shprehin qartë dhe pa asnjë lloj dykuptimësie qëndrimin e OE Health & Light sh.p.k. dhe në fazën e vlerësimit AK nuk ka patur asnjë paqartësi në kuptim të nenit 92(1) të LPP, sepse këto shënime e kanë bërë të cenueshme ofertën ekonomike dhe jo të përgjegjshme / vlefshme sipas nenit 80(2) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për më tepër, sipas nenit 92(1) të LPP, nuk duhet të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Për sa i takon pretendimeve të operatorit ekonomik se, ku pretendon AK në fazën e testimit të tregut ka pranuar Variantin e I-rë të ofertës (më të ulët) së paraqitur nga ky i fundit, ku përcaktohej kushti se pjesët e zëvendësuara do të merren nga OE dhe për këtë qëllim duhej të pranohej oferta e paraqitur në procedurën e prokurimit, KSHA, referuar Relacionit të përlllogaritjes së fondit limit me nr. 1232/41 prot., datë 11.10.2023, të mbajtur nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 605/2023, konkretisht, për Lotin 1 – Mirëmbajtje pajisje mjeksore prodhues Philips shprehet se: nuk u arrit të konkludohet në vlerë nga testimi i tregut...[..], kjo pasi për Lotin 1– Mirëmbajtje pajisje mjeksore prodhues Philips, u administrua vetëm një [1] ofertë ekonomike..., ndodhur në kushtet kur përlllogaritje e fondit nëpërmjet alternativës b) [shënim i KSHA, në Nenin 76 të VKM 285/2021, pika 1, germa b) citohet: studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe] në këto kushte, për sa i përket pretendimeve të OE, KSHA vlen të theksojë faktin se oferta e paraqitur nga ky OE, në fazën e testimit të tregut nga AK, nuk është konsideruar si ofertë e vlefshme, duke mos u marrë parasysh në përlllogaritjen e fondit limit. Për këtë arsye, KSHA vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, si i pabazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Kjo për arsye se, për të bërë të mundur përlllogaritjen e vlerës së prokurimit, grupet e posaçme të punës bazohen në parashikimet përkatëse të LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik.

Për arsyet e renditura më lart, KSHA vlerëson se pretendimi i dytë i operatorit ekonomik ankues nuk qëndron, është i pabazuar në ligj dhe duhet të rrëzohet.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 114, pika 3 Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Dokumenteve Standarde të Tenderit, sipas të cilës “Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:a) pranimin e plotë të ankesës;b) pranimin e pjesshëm të ankesës;c) refuzimin e ankesës.4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”. KSHA referuar edhe arsyetimit të dhënë me sipër, për pretendimin e ngritur nga OE “Health & Light” Sh.p.k., të ngritura në FA me Nr. 394 Prot., datë 31.01.2024, VENDOSI:

- 1. Rrëzimin e ankesës të OE Health & Light sh.p.k., për lotin 1 - Mirëmbajtje pajisje mjekësore prodhues Philips / ose ekuivalent, REF-85014-10-24-2023.*
- 2. Ky vendim t’u komunikohet operatorit ekonomik ankues, Komisionit të Prokurimit Publik dhe operatorëve të tjerë të interesuar.”*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me argumentin e autoritetit kontraktor se: “Sigurimi i ofertës për Lot 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent 1 777 170,688 (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëmbëdhjetë, presje 688) Lekë.

Diferenca ndërmjet ofertës së rënditur në vend të parë, dhe ofertës së renditur në vend të dytë, është 20 415 450 (njëzet milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë.

Për këtë arsye, bazuar në Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285/2021, nuk është i mundur kalimi nga oferta e parë tek oferta vijuese. (Neni 30/8)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në procedurën e mësipërme të prokurimit kanë marrë pjesë dy ofertues, me renditjen si më poshtë vijon:

“MSE” SHPK	68.400.000 lekë, skualifikuar
“Helth&Light” SHPK	88.815.450 lekë, skualifikuar

III.1.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: “kjo pikë do të qëndronte nëse operatori ekonomik i cili ka paraqitur ofertën më të ulët, do të ishte shpallur fitues dhe nuk do të kishte bërë sigurimin e kontratës ose nuk do të nënshkruante kontratën. Në rastin tonë operatori ekonomik i cili ka paraqitur ofertën më të ulët është skualifikuar”, KSHA ka argumentuar si vijon: “Për sa i përket këtij pretendimi të OE, KSHA verifikoi të gjithë dokumentacionin e

administruar nga KVO, ku së pari rezulton se: OE MSE shpk, ka qenë operator ekonomik i kualifikuar, i renditur i pari, dhe arsye e skualifikimit të këtij OE, referuar PV se mbajtur nga KVO, rezulton të jetë mosplotësimi i dokumentacioni të vetëdeklaruar..; Në PV e administruar ndër të tjera citohet se: **Brenda afatit të cituar më sipër, nga OE MSE shpk, për këtë lot nuk u paraqit dokumentacioni i cituar në PV për këtë arsye, oferta e paraqitur nga ky OE nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit dhe specifikimeve teknike të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik në faqen e APP-se, në mbështetje të VKM 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, **neni 80, pika 4**, dhe Ligjin nr. 162, date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” [...].

III.1.3. Në nenin 83, pika 2, 3, 4, 5 dhe 6 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht si më poshtë vijon:

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të:

a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;

b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit.

c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit të ofertës, nëse:

a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës;

b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit;

c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik sipas parashikimeve të këtij neni.

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës.

Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së

kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

III.1.4. Në nenin 30 “Sigurimi i ofertës” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 8, thuhet se:

“ 8. Në rastin kur, është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe asaj në vend të dytë, është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

Me të njëjtin rregull, mund të kalohet tek ofertat e renditura në vijim në rast se diferenca e ofertës së radhës me ofertën fituese fillestare, të mos jetë më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, të renditur para saj.”

III.1.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “MSE” SHPK ka qenë operator ekonomik i kualifikuar, i renditur i pari [...], por është skualifikuar, pasi përpara njoftimit të fituesit, nuk ka plotësuar dokumentacionin e vetëdeklaruar. Sipas KSHA-së, “OE MSE shpk, ka qenë operator ekonomik i kualifikuar, i renditur i pari, dhe arsye e skualifikimit të këtij OE, referuar PV se mbajtur nga KVO, rezulton të jetë mosplotësimi i dokumentacioni të vetëdeklaruar..; Në PV e administruar ndër të tjera citohet se: **Brenda afatit të cituar më sipër, nga OE MSE shpk., për këtë lot nuk u paraqit dokumentacioni i citur në PV për këtë arsye, oferta e paraqitur nga ky OE nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit dhe specifikimeve teknike të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik në faqen e APP-se, në mbështetje të VKM 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, neni 80, pika 4, dhe Ligjin nr. 162, date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”**

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “MSE” SHPK është skualifikuar për mosplotësim të kriterëve të kualifikimit apo specifikimeve teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit dhe të deklaruara të plotësuar nga ana e tij në “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, sipas parashikimeve në ligjin e prokurimit publik, rregullat e prokurimit publik dhe dokumentet standarde të tenderit. Pra operatori ekonomik “MSE” SHPK nuk rezulton të jetë shpallur fitues i procedurës së mësipërme të prokurimit, gjë e cila konstatohet edhe në verifikimin e kryer në SPE, lidhur me fazat e procedurës së prokurimit. Në asnjë rast nuk konstatohet që autoriteti kontraktor të ketë publikuar ndonjë njoftim fituesi në SPE, për këtë procedurë prokurimi. Në kthim - përgjigjen drejtuar ankimuesit KSHA pohon se: “në lex scripta, përcaktohen dy kushte kur AK, mund të kalojë tek oferta e renditur e dyta, konkretisht: 1. Kur ofertuesi nuk bën sigurimin e kontratës, ose 2, kur ofertuesi nuk arrin të nënshkruajë kontratën” dhe më pas shprehet dhe vendos se: “Në referim të sa përcaktohet në dispozitën e sipërcituar (neni 30/8 i VKM-së për miratimin e rregullave të prokurimit publik), pavarësisht parimit, Dura lex, sed lex, KVO, ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore”. Në Shtojcën 3 “Formulari i sigurimit të ofertës”, të dokumenteve të tenderit të publikuar nga autoriteti kontraktor në SPE, inter allia, janë parashikuar rastet në mënyrë

shtruese të transferimit në llogarinë e autoritetit kontraktor nga ana e bankës/kompanisë së sigurimit, të vlerës së sigurimit të ofertës“...nga kërkesa e thjeshtë e autoritetit kontraktor dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme: Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit; Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë; Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.”

Referuar nenit 30, pika 8 të VKM-së mësipërme, në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

Në procedurën e prokurimit objekt – ankimimi, kriter i përcaktimit të ofertës fituese, është “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”. Në kushtet kur ofertuesi “MSE” SHPK me vlerë më të ulët nga dy shoqëritë pjesëmarrëse në tender, nuk është fitues i procedurës së prokurimit, pasi rezulton i skualifikuar nga KVO-ja gjatë vlerësimit të bërë nga ky komision, ky subjekt nuk ka detyrimin ligjor të bëjë sigurimin e kontratës apo të nënshkruajë kontratë (kur nuk është fitues), ndaj dhe autoriteti kontraktor nuk ndodhet në kushtet që të përzgjedhë ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, dhe më pas nuk ligjërohet anulimi i procedurës së prokurimit me argumentin se diferenca ndërmjet ofertës së skualifikuar, por me vlerë më të ulët (në vendin e parë) dhe ofertës së dytë, është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës.

Pra autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar nga “MSE” SHPK, sigurimin e kontratës ose nënshkrimin e kontratës, pasi nuk është shpallur fitues i procedurës së prokurimit. Vetëm në hipotezën se ai do të ishte ofertuesi fitues dhe nuk do të bënte sigurimin e kontratës ose nuk do të arrinte të nënshkruante kontratën, autoriteti kontraktor do të konfiskonte sigurimin e ofertës dhe do të përzgjidhte ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura të mbetura, nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë do të ishte jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr. Autoriteti kontraktor nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 83, pika 6 të LPP-së dhe nenit 30/8 të VKM-së si më sipër cituar, pasi operatori ekonomik “MSE” SHPK nuk është ofertues fitues i procedurës së mësipërme të prokurimit.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “Health&Light” SHPK qëndrojnë.

III.2. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Health&Light” SHPK se: “[...] Duke u bazuar në dokumentacionin e ofertës të këtij OE për Lot 1 si më sipër, në shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, operatori ekonomik ka paraqitur, ndër të tjera, shënimet vijuese:

“1-Pjesët e dëmtuara , të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga Health & Light sh.p.k. 2-Për sa i përket kërkesës në pikën 7 të specifikimeve teknike,

mirëmbajtja korrigjuese: Shoqëria e kontraktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën pajisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor. Ju bëjmë me dije se po ruajmë këtë çmim duke ditur që pajisjet janë transferuar së fundmi dhe nuk do të spostohen më. Për sa i përket rezonancës magnetike, është e pamundur që të transferohen dhe kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës. Përgjegjësinë për to e mbani ju. Kjo është një procedurë për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe nuk kanë lidhje me zhvendosjen dhe nuk është klauzolë e trashëguar nga një kontratë e mëparshme për këto pajisje.”

Lidhur me parashikimin se “1-Pjesët e dëmtuara , të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga Health & Light sh.p.k.”, KVO në zbatim të rekomandimit të KLSH për këtë parashikim, si dhe referuar kontratës së shpallur në këto DT, lloji i mirëmbajtjes është ‘full risk’ që do të thotë që OE i shpallur fitues, duhet të mbulojë të gjitha defektet e pajisjes, e cila është në regjim mirëmbajtje, sipas termave të references, ku përfshihen edhe pjesët e këmbimit. Bazuar në Ligjin nr. 162, date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 92 ‘Shqyrtimi i ofertave’, pika 3 ku parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji, si dhe parashikimet e VKM 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, neni 82, pika 2, ku citohet se: 2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, oferta e paraqitur nga OE Health & Light Shpk., për këtë procedure prokurimi, është në kushtet e ‘mospranimit’ dhe ‘rezervimit’ të termave të references së parashikuar në DT duke marrë mbrapsh pjesët e këmbimit që zëvendësohen nga pajisjet mjeksore, per këtë arsye kjo ofertë është e pavlefshme”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 1 dhe 2 të dokumenteve të tenderit është përcaktuar si vijon:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

III.2.3. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikime Teknike”, pjesë e dokumenteve të tenderit të publikuar në SPE, është parashikuar si më poshtë vijon:

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

“Mirëmbajtje e pajisjeve të mëdha mjekësore të prodhuesit Philips/ose ekuivalent, prodhuesit Siemens/ose ekuivalent, prodhuesit Toshiba/ose ekuivalent dhe prodhuesit GE Healthcare/ose ekuivalent” për 24 muaj”. konkretisht per Lotin 1.

Loti 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent			
Emri i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Shërbimi
Angiograf	Philips	Allura Centron	Shërbimi i Hemodinamikës
Angiograf	Philips	Allura CV 20	Shërbimi i Hemodinamikës
Skaner	Philips	Big Bore	Shërbimi Onkologjik
Rezonancë Magnetike	Philips	Pulsera 1,5T	Shërbimi i Imazherisë
Rezonancë Magnetike	Philips	Ingenia 3,0T	Shërbimi i Neurologjisë

Ndërsa në shtojcën 7 “Formulari i termave të referencës”, është parashikuar si më poshtë vijon:

“Nevojat për organizimin funksional/strukturor të operatorit kontraktues dhe të ofrimit të shërbimit për mirëmbajtjen e plotë “Full Risk” të pajisjeve janë të grupuara në disa kategori, dhe janë të njëjta për çdo grupim në Lote.

Specifikimet Teknike të Përgjithshme

1. Operatori ekonomik duhet të ketë më shumë se një numër kontakti për raportimin e defekteve dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëjë me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe e-mail).
2. Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve.
3. Staf i (i të kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambientet e Kontraktuesit dhe të shoqërohet nga stafi i Sektorit të Inxhinierisë Klinike.
4. Staf i teknik i operatorit ekonomik do të operojë në QSUNT për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes duhet të jetë i siguar pasi kjo e fundit (QSUNT) nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të operatorit ekonomik në ambientet e saj.

Mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore

1. Mirëmbajtja parandaluese apo preventive të pajisjeve mjekësore duhet të kryhet në përputhje me rekomandimet e prodhuesit përkatës për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e tyre dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur pajisjet në gjendjen e duhur të

funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetërimi apo përkeqësimi i performancës.

- 2. Shërbimi për ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore duhet të kryhet nga 2(dy) Inxhinierë/Specialistë të certifikuar dhe të trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi.*
- 3. Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë Rekomandimet nga prodhuesi i pajisjes/ve dhe një plan veprimesh të mirëmbajtjes parandaluese që përcakton periodicitetin, procedurat operative dhe protokollet që synon të përdorë, përfshirë kalibrimet.*

Mirëmbajtja korigjuese e Pajisjeve mjekësore

- 1. Ndërhyrjet e mirëmbajtjes korigjuese konsistojnë në përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionimi, në identifikimin e shkaqeve, eliminimin e tyre dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, për garantimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe sigurisë së saj.*
- 2. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes, riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjese të mundshëm/e gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesorëve të cilat janë të lidhura me të, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit mjekësor si: Tuba X-ray, Dedektorë, Kompjutera, Hard Drive, DVD-CD, Keyboard, Monitor, RAM, Ups, Bllok ushqimi, printer, infrastrukture rrjeti, fisha, sonda, mansheta, sensorë, elektroda, Ingranazhe, pjesë elektronike, elektrike, mekanike, hidraulike, valvula, pjesë mekanike, rrota, pistonat, motorrë etj, dhe ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjes brenda standarteve të përcaktuara nga prodhuesi.*
- 3. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të paraqitet për të kontrolluar e verifikuar defektin brenda 2 orëve nga marrja e njoftimeve (me e-mail dhe/ose telefon te të dhënat e kontaktit të paraqitur) nga Autoriteti Kontraktor për mosfunksionimin normal, probleme të ndryshme apo defekte të pajisjes.*
- 4. Në rastin kur nuk nevojiten pjesë këmbimi, korigjimi i defektit duhet të realizohet jo më vonë se 48 orë pas marrjes së njoftimit.*
- 5. Në rast se konstatohet se për korigjimin e një defekti nevojiten pjesë këmbimi, OE duhet të furnizojë dhe të vendosë pjesët e këmbimit, të riparojë defektin dhe të vendosë pajisjen në gjendje normale pune brenda 7 ditëve kalendarike.*
- 6. Pas riparimeve apo ndërhyrjeve të kryera, zëvendësimi pjesësh këmbimi apo aksesorësh, shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë kalibrimet e nevojshme, verifikimin e parametrave sikurse e rekomandon prodhuesi, për garantimin e funksionimit normal të pajisjes.*
- 7. Shoqëria e kontraktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën pajisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.*

8. Lëvizja, spostimi, çmontimi dhe rimontimi i pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes korrigjuese është në ngarkim dhe përgjegjësi të të Kontraktuarit.

Furnizimi me pjesë këmbimi dhe aksesore

1. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale ose nga prodhues të tjerë të certifikuar, dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, duke siguruar konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen.
2. Të jenë të certifikuara me CE sipas standardeve dhe direktivave të aprovuara në tregun European.
3. Kur është e aplikueshme, pjesët e këmbimit dhe aksesoret duhet të kenë manual instalimi shoqërues sipas rekomandimeve të prodhuesit. Një kopje e këtij mauali i dorëzohet përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor.
4. Pjesët duhet të kenë jo më pak se 1 (një)* vit garanci nga rikthimi në gjendje të plotë funksionale të pajisjes, ku të përfshihen të gjitha defektet e mundshme të tyre.

(Sqarim: Afati i garancisë së pjesëve të këmbimit mund të tejkalojë afatin e kontratës/marrëveshjes së lidhur. I kontraktuari detyrohet të mirëmbajë, sipas kushteve të garancisë, pjesën e këmbimit edhe pas afatit të përfundimit të kësaj kontrate nëse defekti i pjesës ndodh brenda afatit një vjeçar të garancisë së pjesës së këmbimit/ ose arritjen e maksimumit të konsumit të vërtetuar nga prodhuesi.)

Inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore

1. Operatori Ekonomik duhet të kryejë të paktën 1(një) një inspektim sigurie sipas standartit ndërkombëtar elektrik IEC 62353 të specifikuar nga Direktiva e Pajisjeve Mjekësore MDD (ose MDR) 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745 dhe azhornimet përkatëse, sipas aplikueshmërisë dhe Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Evropës, për çdo pajisje mjekësore dhe pjesëve përbërëse të saj gjatë periudhës së kësaj kontrate, nëpërmjet stafit të trajnuar dhe certifikuar, sipas nevojave të AK.
2. Operatori Ekonomik duhet të kryejë inspektim vizual, testime dhe matje me aparatura të kalibruara, në bashkëpunim me stafin e AK bazuar në specifikimet e prodhuesit.
3. Në përfundim të çdo inspektimi sigurie duhet të përpilohet një raport përshkrues dhe firmoset nga specialistët e AK dhe Inxhinieri/Tekniku i kompanisë (OE) që kryen testin.
4. Pas çdo testimi sigurie në pajisje duhet vendosur një shenjë treguese (të standardizuar nga AK) e gjendjes së sigurisë së pajisjes.
5. Përveç rasteve të sipërpërmendura, shërbimi i inspektimit e verifikimit të sigurisë duhet të kryhet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.

6. *Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta dhe Kontraktuesi është i detyruar të pranojë këto kërkesa pa kushte.]*

III.2.4. Nga shqyrtimi i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Health&Light” SHPK, rezulton, se në Formularin “Lista e çmimeve të shërbimeve”, është shtuar shënimi si vijon:

Shënim:

- Kjo oferte është e vlefshme vetëm për aparatet që janë në gjendje pune. Nëse aparatet janë me defekt, ato duhet të riparohen dhe më pas në do të nënshkruajmë kontratën e mirëmbajtjes me institucionin respektiv.
- Rënia e cilësisë së imazhit, që i detyrohet punës së aparatit prej shumë vitesh dhe numrit të madh të ekzaminimeve në ditë, nuk quhet defekt. Në riparojmë të gjitha defektet “full risk” por duhet të keni parasysh që aparatet nuk janë në vitin e parë të punës, por në vitin e 10-13 dhe mbajnë peshën e punës në Qendren Spitalore Universitare “Nene Tereza”.
- Pjesët e dëmtuara, të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga HEALTH&LIGHT shpk.
- Hyrja e automjeteve të operatorit në mjediset e spitaleve (aty ku aplikohet) nuk duhet të jetë subjekt i aplikimit të tarifave që aplikohen për qytetarët, ose të pajisemi përkatësisht me karta të rregullta hyrjeje.
- Përsa i përket kërkesës në pikën 7 të specifikimeve teknike, mirëmbajtja korrigjuese: *Shoqëria e kontraktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën pajisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor*, Ju bëjme me dije se po ruajmë këtë çmim duke ditur që pajisjet janë transferuar së fundmi dhe nuk do të spostohej më. Përsa i përket rezonancave magnetike, është e pamundur që të transferohen dhe kjo nuk ndodh në asnjë vend të botes. Përgjegjësinë për to e mbani Ju. Kjo është një procedurë për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe nuk kanë lidhje me zhvendosjen dhe nuk është klauzole e trashëguar nga kontratë e mëparshme për këto pajisje.

III.2.5. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*”

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*”

III.2.6. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

III.2.7. Në nenin 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave”, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Pas afatit përfundimtar për hapjen e ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.*
- 2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.*
- 3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.*

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

- 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*
- 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*
- 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.8. KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon, se zbatimi i parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Health & Light” SHPK në Shtojcën 2 “Lista e çmimeve të shërbimeve”, pjesë e ofertës së tij, është shprehur, përveç të tjerave se “[...] Pjesët e dëmtuara, të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga Health & Light ShPK [...]”, përcaktim/kusht i cili nuk është parashikuar në dokumentet e tenderit. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2, të VKM-së nr. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”

Ndaj shënimi i bërë nga ankimuesi “Pjesët e dëmtuara, të cilat do të zëvendësohen me pjesë këmbimi të reja, do të merren nga Health & Light sh.p.k”, është shmangie e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit, pasi në specifikimet teknike dhe termat e referencës nuk është parashikuar një gjë e tillë.

KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjisllacionin në fuqi.

Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementesh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik “Health &

Light” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2.9. Gjithashtu, rezulton, se në Shtojcën 2 “Lista e çmimeve të shërbimeve”, ankimuesi është shprehur, se “Për sa i përket kërkesës në pikën 7 të specifikimeve teknike, mirëmbajtja korigjuese: Shoqëria e kontraktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën pajisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimi. Nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, Ju bëjmë me dije se po ruajmë këtë çmim duke ditur që pajisjet janë transferuar së fundmi dhe nuk do të spostohen më. Për sa i përket rezonancës magnetike, është e pamundur që të transferohen dhe kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës. Përgjegjësinë për to e mbani ju. Kjo është një procedurë për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe nuk kanë lidhje me zhvendosjen dhe nuk është klauzolë e trashëguar nga një kontratë e mëparshme për këto pajisje”, në kundërshtim me pikën 7 të termave të referencës, “Mirëmbajtja korigjuese e pajisjeve mjekësore”, pjesë e dokumenteve të tenderit, ku thuhet se: “Shoqëria e kontraktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën pajisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor”.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Është barrë e operatorit ekonomik ankimues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekti-shqyrtimi, të paraqesë informacion dhe dokumentacion të saktë dhe të

vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat dhe kushtet e parashikuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e *lex specialis* për prokurimin publik. Për më tepër, si kusht për shpalljen fitues, një ofertuesi nuk duhet t'i lejohet *shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuar në dokumentet e tenderit* apo vendosja e *kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuar në dokumentet e tenderit* dhe të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën si në rastin konkret.

Nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet se “*1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*” Akoma më tej, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të tyre. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave, parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “*1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-85014-10-24-2023, me objekt: “Loti 1 - Mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent”, me fond limit 88 858 534.38 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

